



Prishtinë, 12.11 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1317_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084),
- Dispozitën e Nenit 16, paragrafi 1.41 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085),
- Nenin 16 të licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit,
- Paragrafin 7.1.1 të Rregullave të Tregut,
- Kërkesën e KOSTT të datës 1 tetor 2020 për aprovimin e Procedurës për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive,

në seancën e mbajtur me 12 nëntor 2020, nxori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet dokumenti *Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive*

Arsyetim

Në vitin 2007 KOSTT ka zhvilluar dokumentin Procedurat Operacionale për alokimin e kapaciteteve transmetuese, të cilën ZRRE e ka aprovuar me datë 30.01.2007.

Në vitin 2015, si amendamentim të dokumentit Procedurat Operacionale për alokimin e kapaciteteve transmetuese, KOSTT ka zhvilluar dokumentin *Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimet e Kapaciteteve Ndër-Kufitare*, të cilën ZRRE e ka aprovuar me datë 10.04.2015.

Me datë 01 tetor 2020 Zyra e Rregullatorit për Energji ka pranuar kërkesën e KOSTT për aprovimin e Procedurës për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive.

Deri me tash implementimi i këtij dokumenti ka qenë i pamundur për shkak se KOSTT nuk ka qenë i pranuar si Operator i sistemit të transmetimit (zonë rregulluese) dhe nuk ka pasur të mundur të bëjë alokimin e kapaciteteve interkonektive. Me krijimin e rrethanave të reja për KOSTT së shpejti do të filloi të funksionoi si zonë rregulluese dhe do të bëjë alokimin e kapaciteteve Interkonektive, kështu që



KOSTT ka zhvilluar versionin e ri të dokumentit të titulluar *Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive* dhe e ka dërguar për aprovim në ZRRE.

ZRRE ka shqyrtuar, komentuar dhe vlerësuar dokumentin, dhe konsideron se dokumenti plotëson kriteret e nevojshme për kryerjen e aktivitetit për alokimin e kapaciteteve dhe e ka parë të arsyeshme që të **Aprovohet** dokumenti *Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive*.

Hyrja në fuqi e këtij dokumenti shfuqizon dokumentin *Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimet e Kapaciteteve Ndër-Kufitare* të aprovuar nga Bordi i ZRRE-së me datë 10.04.2015.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- Të licencuarit – KOSTT SH.A,
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bordi i ZRRE-së;

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejriqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar